



EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

21-22

MAJ
10:00-15:00

TEMAT:

- SNA 250 - Konsiderimi i ligjeve dhe rregulloreve në një auditim të pasqyrave financiare;
- SNA 540 - Auditimi i vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet përkatëse;
- SNA 700 - Formimi i Opinionit dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare.

LIGJËRUES:

- Gëzim Mustafa – Auditor Ligjor

Në kuadër të programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) organizon sesionin e radhës të EVP.

Temat:

- SNA 250 - Konsiderimi i ligjeve dhe rregulloreve në një auditim të pasqyrave financiare;
- SNA 540 - Auditimi i vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet përkatëse;
- SNA 700 - Formimi i Opinionit dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare.

Data: 21-22 maj, 2025

Orari: 10:00 – 15:00 (pauza e drekës 12:00-13:00)

Ligjërues: Gëzim Mustafa – Auditor Ligjor

Regjistrohu për pjesëmarrje në EVP deri më 20/05/2025 në: <https://portal.scaak.org/>

***përmes portalit ju mund të zgjedhni të merrni pjesë fizikisht apo online si dhe të gjeneroni profaturën**

***regjistrimi në portal vlenë vetëm për anëtarët aktiv të ShKÇAK**

***sesionet që janë 2 ditore nënkupton se përmbajnë tema të kombinuara dhe kanë vazhdimësi p.sh. dita 1 me ditën 2. Në momentin që konfirmoni sesion 2 ditore obligoheni që të merrni pjesë në 2 ditët e EVP-së.**

Ndërsa anëtarët jo aktiv dhe të interesuarit e jashtëm për pjesëmarrje në EVP mund të na kontaktojnë përmes: administrata@scaak.org

Ky seminar do t'iu sigurojë tetë (8) orë të verifikueshme të EVP-së, që rezulton në pagesë totale prej EUR 160.00, ndërsa për anëtarët aktiv për vitin 2025 EUR 80.00.

Pagesat duhet që të kryhen në njërin nga Llogaritë bankare si në vijim:

Banka: ProCredit Bank
Xhrll. Nr. 1110161271000192

Banka Për Biznes
Xhrll. Nr. 1300271200089555

Përshkrimi-Për: ShKAK SCAAK

*Konfirmimi për pjesëmarrje dhe pagesa është e obligueshme ndërsa për vendin e saktë do t'iu informojmë pas pranimit të konfirmimeve.

** Kjo temë e EVP është në kuadër të temave të obligueshme.

*** Edukimi i Vazhdueshëm Profesional është i obligueshëm për anëtarët e ShKÇAK, për thirrjet si në vijim:

Auditorët ligjor – obligohen që të kenë 40 orë të EVP brenda vitit kalendarik, prej të cilave së paku 24 orë të verifikueshme. Nga orët e verifikueshme 12 orë duhet të jenë nga temat e obligueshme.

Auditorët e Çertifikuar dhe Kontabilistët e Çertifikuar – obligohen që të kenë 20 orë të EVP brenda vitit kalendarik, prej të cilave së paku 12 orë të verifikueshme. Nga orët e verifikueshme 6 orë duhet të jenë nga temat e obligueshme. *Auditorët e Çertifikuar që synojnë të aplikojnë për licencë "Auditor Ligjor" duhet të kenë parasysh se sipas UA Nr. 01/2019 kërkohen nga **24 orë të verifikueshme në 3 vitet e fundit.***

Auditorët e Brendshëm të Çertifikuar – obligohen që të kenë 30 orë të EVP brenda vitit kalendarik, prej të cilave së paku 12 orë të verifikueshme. Nga orët e verifikueshme 6 orë duhet të jenë nga temat e obligueshme.

Planin vjetor të EVP për vitin 2025 mund t'a shkarkoni duke klikuar [KËTU](#)